

URDHËR
Nr.218, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.160, DATË 11.3.2020 “PËR
NDËRPRERJEN E NDËRHYRJEVE KIRURGJIKALE TË PLANIFIKUARA NË TË
GJITHË STRUKTURAT SPITALORE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ligjit nr.9106, datë 17.7.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10 107, datë 30.3.2009 Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr.160, datë 11.3.2020 “Për ndërprerjen e ndërhyrjeve kirurgjike të planifikuara në të gjithë strukturat spitalore publike dhe jopublike”, togfjalëshi “deri në datën 3 prill 2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**